

Arrestohen dy të dyshuar në Gjilan, në nëntor të 2021-ës kishin grabitur para nga makina e një banke



17/01/2023 15:26

f

t

Policia e Kosovës, ka njoftuar se janë arrestuar dy të dyshuar për grabitje në Gjilan.

Përmes një njoftimi, policia ka bërë të ditur se të njëjtit kishin qenë të përfshirë në një grabitje të armatosur e ndodhur në fshatin Parallovë në rrugën Gjilan-Prishtinë, përcjell [lajmi.net](#).

“Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan, Njësi i Hetimeve Rajonale Gjilan si rezultat i një pune mirë të organizuar operacionale dhe veprimeve hetimore disa mujore kanë arritur që sot me datën 17.01.2023 të arrestojë dy të dyshuar kosovar shqiptar A.B. (1982) dhe V.S. (1992). Arrestimi i të dyshuarve nga ana e hetuesve policor rajonal është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Shtetit dhe me urdhëresë të gjykatës janë kontrolluar lokacione të ndryshme në komunën e Prishtinës dhe Fushë Kosovës me këtë rast është arritur të sigurohen prova se të njëjtit me datën 18.11.2021 në bashkëveprim edhe me katër të dyshuar të tjerë të arrestuar më herët kanë qenë të përfshirë në një grabitje të armatosur e ndodhur në fshatin Parallovë në rrugën Gjilan-Prishtinë.”, thuhet në njoftim.

PK njofton se të dyshuarit kishin shtënë më armë në drejtim të një kombi të një kompanie për transportimin e parave të një banke, dhe iu kishte grabitur një shumë parash.

Pas kontrollit nga policia iu janë gjetur dhe sekuestruar armë, fishekë, para dhe prova tjera materiale.

“Gjatë kontrollit në shtëpitë dhe objektet përcjellëse të dy të dyshuarve janë gjetur dhe konfiskuar si provë materiale për gjykatën: një (1) pistoletë e llojit TT, dy (2) karikatorë të armës së njëjtë, trembëdhjetë (13) copë fishekë të kalibrit 7.62 mm, para në vlerë 2600 euro, dy (2) karikatorë të zbrazët të armës AK/47, një (1) kondak i armës AK/47, trembëdhjetë (13) copë fishekë të armës AK/47 si dhe gjatë (6) copë gëzhoja të kalibrit 7.62 mm. të pushkës automatike.”, shkruan [PK/Lajmi.net/](#)



Artikuj të ngjashëm

January 18, 2023

Lajçak takohet me Vuçiq në Zvicër

January 18, 2023

Rrëzohet helikopteri në Kiev, vdes ministri i Brendshëm

January 18, 2023

Vetaksident në Parallovë, kamioni del jashtë rrugës

January 18, 2023

Hoti për Kurtin: Pagoi pa procedurë prokurimi 58 mijë franga për...

January 18, 2023

Kurti: Jam optimist se brenda pak muajsh mund të arrijmë marrëveshje...

January 18, 2023

Rasti Berishaj, ish-kryeministri slloven kritikon parlamentin